



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0625

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Selmans Network Sh.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapsirave publike me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1, me 20.09.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa me nr. 2024/0625 e datës 12.07.2024 e Operatorit Ekonomik (OE) Selmans Network Sh.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapsirave publike me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës.

2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58), për dhënie të një kontrate të datës 24.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartë cekur si në pikën 1 të dispozitivit.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas nenit 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.11.2023 Komuna e Gjakovës., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapsirave publike me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1.

Me 24.06.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin (B58) e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik: JOOS Krasniqi & Berisha Com & Fonderia.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë me vlerë të parashikuar të kontratës 1,570,000.00 euro.

Me 28.06.2024 OE Selmans Network Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Më 03.07.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Selmans Network Sh.P.K., me numër protokoll 2024/0625 lidhur me aktivitetin e prokurimit Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapsirave publike me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Selmans Network Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, ka shkelur Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092, veçanërisht Nenin 7 të këtij ligji, që trajton Barazinë në trajtim dhe jo-diskriminimin, në paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5. Shkeljet e konstatuara janë si më poshtë:

a. Komuna e Gjakovës ka vepruar në kundërshtim me këtë nen gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit publik, duke shpallur fitues një Operator Ekonomik (OE) që është administrativisht i papërgjegjshëm dhe që ka përfituar favorizime në vlerësimin e tenderit.

b. Pas shqyrtimit të dokumenteve dhe analizimit të dosjes së tenderit, është verifikuar se Komuna ka shpallur fitues një OE të cilin ka favorizuar në mënyrë esenciale, duke e shpallur fitues edhe pse nuk ka përmbushur kërkesat e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike të kërkuara.

Pretendimi i dytë (II): Komuna e Gjakovës ka shkelur Ligjin për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij, veçanërisht Nenin 28, në lidhje me Specifikimet Teknike, paragrafët 2, 6, 7, 8, dhe 9. Shkeljet janë si më poshtë:

a. Gjatë vlerësimit të dosjes së tenderit dhe ofertave, Komuna ka shpejtuar dhënien e kontratës për OE fitues pa analizuar kërkesat dhe specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

b. Komuna ka shpallur fitues një OE që nuk ka paraqitur deklaratën e kërkuar për përputhshmëri me specifikimet teknike dhe çertifikatat e kërkuara në dosjen e tenderit.

c. Shkelje e specifikimeve teknike dhe kërkesave të dosjes së tenderit është bërë gjithashtu duke shpallur fitues OE që ka paraqitur dokumente të falsifikuara si katalogë dhe çertifikata që nuk përputhen me produktet e kërkuara.

d. Komisioni vlerësues ka vlerësuar si të rregullta mostra të cilat nuk përputhen me kërkesat e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike, përfshirë edhe mostra që janë prodhuar nga një tjetër prodhues.

e. Komuna ka dështuar të vlerësojë dhe verifikojë përputhshmërinë e autorizimeve dhe garancioneve, duke shpallur fitues OE që ka paraqitur dokumente mashtruese.

Pretendimi i tretë (III): Komuna e Gjakovës ka shkelur Ligjin për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, sidomos Nenin 59 dhe Rregulloren 001/2023, në lidhje me Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve. Shkeljet janë si më poshtë:

a. Komisioni Vlerësues ka shpallur fitues një OE që është administrativisht i papërgjegjshëm, për shkak të mungesës së deklaratës për specifikimet teknike.

b. OE i shpallur fitues ka paraqitur dokumente që nuk janë të përputhshme me kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike të kërkuara, përfshirë dokumente të falsifikuara dhe katalogë që nuk përputhen me produktet e ofruara.

c. Komisioni ka bërë një analizë të dobët të mostrave, duke miratuar mostra që nuk përputhen me kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit dhe që nuk janë të prodhuara nga kompani të autorizuar.

d. Dokumentet e prezantuara si autorizime dhe garancione nga OE fitues janë të falsifikuara dhe nuk përkojnë me standardet dhe kërkesat e tenderit.

Në përfundim, duke u bazuar në shkeljet e konstatuara dhe pretendimet e paraqitura, kërkohet që Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të anulojë vendimin për dhënien e kontratës dhe të kthejë lëndën për rivlerësim. Gjithashtu, duhet të rekomandohet që gjatë rivlerësimit të ofertave të shpallet fitues OE që përmbush të gjitha kërkesat e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike, me çmimin më të lirë.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik Selmans Network Sh.P.K., me datën 28.06.2024, ka parashtruar një kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, nr. i prokurimit 632-23-13225-5-1-1, NT. i brendshëm 632-23-004-511.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, më datën 03.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka dhënë këto përgjigje:

1.Pretendimi se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) nuk qëndron, pasi Autoriteti Kontraktues, në përputhje me nenin... të LPP-së, ka rekomanduar për kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomikë të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

2.Pretendimi lidhur me specifikimet teknike të aneksit 1 nuk qëndron, sepse Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë ka paraqitur deklaratën siç është kërkuar në FDT.

3.Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në FDT nuk ka qenë që OE të dorëzojë deklaratën se mostrat do të jenë të gatshme për prezantim, por që OE së bashku me ofertën të dorëzojë mostrat. Prandaj, pretendimi në këtë lidhje nuk qëndron.

4.Pretendimi se Grupi i Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontratë ka paraqitur deklarata dhe dokumente mashtruese nuk qëndron, sepse vërtetimi i këtij pretendimi nuk është në kompetencë të Autoritetit Kontraktues.

5.Sa i përket pozicioneve 3, 4, 5, dhe 6, Autoriteti Kontraktues i konsideron si devijime të vogla në përputhje me nenin 59.4 të LPP-së, dhe për këtë arsye ky pretendim nuk qëndron.

6.Pretendimi lidhur me autorizimet dhe garancionet për produktet në pozitat 193 dhe 197 nuk qëndron, dhe i njëjti plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues në FDT.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0625, ndërsa me datë 29.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0625 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Selmans Network Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0625 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë argumenton se OE të rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm për shkak të mungesës së deklaratës për specifika teknike. Pas shqyrtimit, është konfirmuar se OE ka ofruar një deklaratë për specifika teknike, të cilën e ka vulosur dhe nënshkruar nga të tre anëtarët e grupit, duke e bërë këtë pretendim të pabazuar. Pretendimi i dytë thekson se OE i rekomanduar nuk plotëson disa kërkesa të specifikimeve teknike. Për pozicionin 3, ku kërkohet një ulëse me gjatësi 3300mm, OE i rekomanduar ka ofruar një ulëse me gjatësi 2500mm dhe me 8 dërrasa, ndërsa kërkesa ishte për 7 dërrasa. Për pozicionet 90 deri 94, është pretenduar se OE i rekomanduar nuk ka përfshirë pozitat 90 dhe 92 në autorizim. Pretendimet lidhur me fontanën janë të paqarta, por për pjesën tjetër të specifikimeve teknike, vërejtjet janë të bazuara. Pozicioni 3 nuk është gjetur në katalogun e prodhuesit Benito Urban, dhe autorizimi për pozicionin 5 nuk është për këtë aktivitet. Po ashtu, fotografia e mostrës së ofruar nga OE ankues tregon një ulëse me dizajn që nuk përputhet me kërkesat e specifikimeve teknike të publikuara më 24.11.2023. Standardi për pllakat terrazzo është ofruar për EN1339:2003, ndërsa kërkohet standardi

EN13748-2, duke e bërë këtë pretendim të bazuar dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat për specifikimet teknike të pozicioneve të cekura. Pretendimet lidhur me autorizimet janë pjesërisht të bazuara, ku autorizimi nga Benito mban emrin e gabuar të aktivitetit dhe autorizimi nga Lambario – Ambienne nuk është për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë, këto gabime nuk janë të mjaftueshme për eliminimin e OE. Pretendimi i fundit është kundër OE N.SH.T. VIKTORY COM; Marisa SH.P.K.; Toifor Sh.p.k., ku është pretenduar se grupi është i papërgjegjshëm dhe nuk ka përmbushur kërkesat administrative, pasi mungon një deklaratë e qartë nga anëtarë i Konsorciumit NSHT VIKTORY COM për pjesëmarrjen në grup dhe për mos pjesëmarrjen në mënyrë individuale ose në ndonjë grup tjetër. Ky pretendim është vlerësuar si i bazuar, duke çuar në konstatimin se OE nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes-specifikimit teknik.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrirat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën me nr. 2024/0625 duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht të bazuar, por e cila nuk ka bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapsirave publike"., me numër të prokurimit: 632-23-13225-5-1-1, iniciuar nga (AK) – Komuna e Gjakovës.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues nuk i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, pasi që, gjatë, ekzaminimit, administrimit të provave si dhe raportit të ekspertit shqyrtues, sipas pikës ankimore lidhur me pozicionin 03 ku është kërkuar ulëse: 3300 mm, kurse OE I rekomanduar për kontratë ka ofruar ulëse 2500mm, dhe se kërkesa ka qenë ulëse me 7 dërrasa, ndërsa është ofruar me 8 në dokumentin shtojcë tek specifikat teknike të detyruara figura nr. 2 përshkruhet gjatësia që mund të shfrytëzohet edhe 2500 mm, ndërsa pjesa tjetër sipas fotografisë shihet si aksesore, dhe e pa shfrytëzueshme, nësi Paneli Shqyrtues konsiderojmë që bije mbi përgjegjësi e AK-se që sipas nenit 59 të LPP-se kur pranohet dhe arsyetohet devijimet e vogla sipas nenit 59.4 (ii) të cilat nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të

tenderit; me kusht qe çfarëdo devijimi I tillë te kuantifikohet , aq sa është e mundshme , dhe te merret parasysh gjate vlerësimit dhe krahasimit te ofertave. Mbi këtë bazë, dhe duke marrë parasysh qëllimin e LPP-se e qe është te siguroj ne mënyra me efikase , me transparente dhe me te drejte e shfrytëzimin e fondeve publike ,si njërin nder parimet kryesore te LPP-se qe eshte përcaktuar ne nenin 6 të LPP economiciteti dhe efikasiteti , andaj çeshtjen kontestuese ne këto pika ankimore edhe Paneli Shqyrtues e mbështet vendimin e AK, i cili këtë e ka konsideruar si devijim te vogël. Ne piken ankimore lidhur me autorizimet ku thuhet qe autorizimi i ofruar vetëm për tenderin e pare, para se e ri tenderohet nuk ka ndonjë dëshmi se është tërhequr ndonjëra pale se autorizimi i lëshuar është tërhequr. Lidhur me piken ankimore për pozicionin 4 ku OE ankues ka pretenduar se mostrat e OE te rekomanduar i mungon elementi thelbësor qasja për persona me aftësi te kufizuara dhe se e vetmja ngjashmëri është se te dyja janë fontana , ne dosje nuk vërehet se ka pasur ndonjë kerkes specifike përkitazi me qasjen e mundshme siç pretendohet ne ankesë, ne këtë pike edhe ekspertit shqyrtues e ka cekur se nuk ka pasur si ta konstatoj. Sa i përket pozicioneve 90-94 OE I rekomanduar ka prezantuar dëshmi nga prodhuesi gjerman Kronimuss, po ashtu, gjendet edhe autorizimi , katalogu dhe garancioni i prezantuar i prodhuesit Kronimuss , Mos cekja e dy pozicioneve ne raport me faktin se VOR Com është prodhues dhe është prezantuar autorizimi për pllaka terrazzo nuk përbën ndryshim material ne raport me natyrën dhe qëllimin e kësaj procedure dhe ne raport e parimin kryesor te ruajtjes se parasë publike , përkatësisht economicitetit . Po ashtu sa i përket autorizimeve te kontestuara nga OE ankues edhe ekspertit shqyrtues e ka cekur se nuk mund te jepen konstatimet se mund te jenë arsyeje për eliminim , ndërsa lëshimet eventuale tek autorizimet kur ekziston titulli I aktivitetit ka mundur edhe te sqarohen sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se , ne raste se do te konsideroheshin me dilema këto autorizime , ndryshe duhet te merret parasysh paragrafi 4 i nenit 59 te LPP-se , pika (ii) kur këto çështje nuk ndikojnë ne substancë dhe ne aspektin thelbësor dhe ne kushte te kontratës, nga te gjitha te lartshënuar dhe ne raport me interesin publik në kuptim të nenit 6 të LPP-se. Lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciuse e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e ekspertit shqyrtues. Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, edhe në këtë rast, AK ka vazhduar të refuzojë raportin e ekspertit, duke ripërsëritur se AK e konsideron ofertën OE të rekomanduar si të përgjegjshme, dhe disa nga të gjeturat i ka konsideruar si devijime të vogla.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar duke u bazuar në nenet 59 dhe 60 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: *“Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës”*, atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit) dhe duke e pasur parasysh se AK në mendimin e tyre në relacion me raportin e ekspertizës ka deklaruar se është në diskrecion të AK vënia në zbatim edhe e neni 59.4 sa i përket devijimeve të vogla, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e economicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç’rast konstatohet në

mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

- Përfundimi –

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK, sepse aplikimi i devijimeve të vogla siç përcakton edhe legjislacioni në fuqi konkretisht neni 59 par. 4 të LPP-së, ku përgjegjësin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit në Gjykatën Komerciale/Departamentit për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - SELMANS NETWORK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: